

Thirrje për pjesëmarrës

Trajnim i RNR në Ballkanin Perëndimor: "Komunikimi me individë të radikalizuar"

12-13 qershor 2023, Beograd, Serbi

Konteksti

Puna me individë të radikalizuar kërkon komunikim për të fituar besimin e tyre dhe për të punuar në ndryshimin ideologjik dhe/ose të sjelljes së tyre. Për të arritur këtë mund të jetë një proces sfidues dhe që kërkon kohë. Pikëpamja e tyre e fortë e botës bardh e zi e bën të vështirë shkëmbimin.

- Pengesa e parë është ideja e ndarjes ne-ata. Kryesisht, praktikuesit në fillim do të konsiderohen se nuk janë të vlefshëm për t'u biseduar me ta pasi nuk janë njëri prej tyre dhe - bile edhe më keq - mund të shihen si kundërshtarë.
- Pengesa e dytë është se individët shpesh e fshehin personalitetin e tyre pas një mburoje ideologjike, se si grupi ekstremist pret që ata të veprojnë (reagojnë). Kjo sjellje mund të jetë pjesë e përshtatjes së pavetëdijshme për mënyrën se si zhvillohet ndërveprimi në një grup të radikalizuar, gjithashtu mund të përdoret në një mënyrë më të vetëdijshme për t'i mbajtur njerëzit në distancë.
- Aspekti i tretë janë bindjet e forta që i kanë individët e radikalizuar, duke mos lënë kështu shumë hapësirë për diskutim dhe duke lënë vetëm pak mundësi për të pasur një bisedë kuptimplote.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të mësojnë se si të dinë se janë në kontakt me një individ të radikalizuar, çfarë është mendësia radikale dhe çfarë pasojash ka kjo për komunikimin, teknikat e bisedës dhe si të garantohet siguria për praktikuesit dhe individët e radikalizuar. Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e mëposhtme përmes 5 moduleve të ndryshme:

- Njohuritë: njohuri mbi mendësinë radikale dhe parimet e teknikave të bisedës që mund të përdoren.
- Aftësitë: si të bëni pyetje në mënyrë efektive dhe si t'i përgjigjeni komunikimit verbal dhe joverbal.
- Kompetencat: të përgatiteni më mirë, të zhvilloni dhe të ndiqni më mirë një bisedë me një individ të radikalizuar dhe të jeni të vetëdijshëm për efektet e sjelljes suaj.

Grupi i synuar

Grupi i synuar i këtij trajnimi janë punonjësit socialë dhe punonjësit me të rinjtë që punojnë me individë të radikalizuar ose të cenueshëm ndaj tij. Ka vend për 15 pjesëmarrës me pjesëmarrje të barabartë nga shtetet e ndryshme të Ballkanit Perëndimor. Përkthimi simultan mund të sigurohet bazuar në nevojat e pjesëmarrësve.

Aplikimi

Ju lutemi që ta plotësoni [këtë pyetësor](#) përpara datës 12 maj. Ne do të zgjedhim pjesëmarrësit në bazë të përgjigjeve të tyre.